



**K.DH.SH.II.nr.970/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A...” ShPK me seli në Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.443/19, të datës 18.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.02.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit “A...” ShPK me seli në Prishtinë, e datës 24.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.443/19, i datës 18.03.2021, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa ka mbetur në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/659, 708 i datës 26.12.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe i ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e parashtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.443/19 i datës 09.03.2021, të anulohet si i pabazuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.443/19 i datës 09.03.2021, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës 01.3.2.2/659, 708 datë 26.12.2018, sipas të cilit vendim është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve DUD-ave kontestues.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.01.3.2.2/659, 708 të datës 26.12.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “A...” ShPK me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve R-9452/06.10.2018, R-9453/06.10.2018, R-1068/09.11.2018 dhe R-10711/12.11.2018 të ZBD Prishtina 3.

Me këtë aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror, subjektit në procedurë, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas deklaratave doganore të lartcekura dhe në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 09.03.2021, në prani të përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/659, 708 datë 26.12.2018. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se Gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit se vlera e deklaruar e mallit përputhet plotësisht me vlerën e faturave dhe pagesat bankare të kryera në emër të faturave të blerjes së mallit, e i cili pretendim është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës, në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, sepse për Gjykatën për tu pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit- eksportuesit me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare. Gjykata ka gjetur se në shkresat e lëndës edhe pse gjenden dy transfere bankare të datës 12.12.2018 dhe 17.10.2018, që të dyja këto transfere janë me status “në pritje për tu ekzekutuar” e që për gjykatën këto transfere nuk mund të pranohen si dëshmi që është bërë pagesa sipas faturave përcjellëse për DUD-at kontestues. Tutje pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provën faturat e mallit e që njëra nga këto fatura, ajo me numër LU1805 e datës 28.09.2019, nuk është e kompletuar sepse e njëjta nuk ka as shumë- vlerën e përgjithshme të faturës, andaj edhe mbi bazën e këtyre të cekurave si më lartë nuk arriti të dëshmojë vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e mallit lëndor , e që është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar në këtë lëndë të konflikt administrativ nuk ka arritur të dëshmohet nga pala paditëse.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke

vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se e paditura ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Kodit Doganor me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të lartcekur. Këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se paditësi nuk ka prezantuar fakte të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale të mallit sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, pasi që transferet bankare të prezantuara nga paditësi, nuk mund të pranohen si valide nga gjykata për faktin se të njëjta janë me status “në pritje për tu ekzekutuar”. Tutje paditësi pretendon se “I gjithë arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë është i bazuar vetëm në anë se paditësi duke qenë se ka qenë i obliguar që me anë të provave të vërtetoj pretendimet e tij nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë sepse nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme. Këtë konstatim Gjykata e ka bazuar në faktin se sipas saj ka munguar deklarata eksportuese dhe kontrata me dërguesin e mallit. Mirëpo gjykata po ashtu si organ i paditur nuk e ka cekur bazën ligjore ku e bazon këtë konstatim. Në cilin nen të KDA-së thuhet se gjatë zhdoganimit duhet të paraqitet deklarata eksportuese edhe kontrata me dërguesin e mallit”. Kolegji i kësaj gjykate konstaton se ky pretendim i paditësit është i pabazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e mallit lëndor është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër, e që në këtë konflikt administrativ nuk ka arritur të dëshmohet nga pala paditëse, pasi që transaksionet bankare të datës 12.12.2018 dhe 17.10.2018 janë me status “në pritje për tu ekzekutuar” dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dëshmi se është bërë pagesa sipas faturave përcjellëse për DUD-at kontestues konform nenit 33 të KDAK-së i cili nen parasheh që *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.970/22, me datë 23.02.2023**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**